



Komuna e Suharekës, Kryetari z. Bali Muharremaj

(Draft raport)

Kryetari i Komunës z. Bali Muharremaj me datë 12.12.2017, ka pranuar detyrën e Kryetarit të Komunës, ndërsa me 20.12.2018, në mënyrë solemne ka bërë betimin para këshilltarëve të Asamblesë Komunale.

Pas marrjes së detyrës, fokus kryesorë ishte përfundimi i projekteve për vitin 2017, ku me këtë rast arriti që komuna të mos shkojë në suficit në shumën prej 500,000.00 Euro.

Ashtu siq kishte premtuar gjatë fushatës zgjedhore, punën e tij e filloj në disa nga lokalitetet e Komunës tonë si: Budakovë, Sallagrazhdë, Studençan, Savrovë, Samadraxhë, Tërrnje, Grejkoc etj, duke u takuar me banorët e këtyre pjesëve, për tu njohur nga afër për brenga dhe shqetësimet e tyre. Gjithashtu vizitoi edhe disa ndërmarrje si: “Arta Tex” në Mushtisht, ku dhe drekoi se bashku me puntorët e kësaj ndërmarrje mbrenda kuzhinës së saj.

Kryetari Muharremaj në 3 mujorin e pare, e ka pritur në vizitë delegacione vendore dhe ndërkombëtare, si nga Qeveria e Kosovës, përfaqësues nga Konzullata të ndryshme, Bshkësive Fetare, Forcave të Sigurisë së Kosovës, Policisë, USAID, organizata tjera të ndryshme etj.

Duke parë gjendjen në Komunë, shqetësimet e shumta të qytetarëve të cilët kanë nevojë për zgjidhje, Kryetari Muharremaj ka caktuar takime të përvajshme me qytetarë, ku deri me tani në zyrën e tij ka pritur mbi 872 qytetarë.

Branda kësaj periudhe me propozim të Kryetarit Muharremaj, dhe me përkrahje të Asamblesë Komunale është shpallur Qytetar Nderi i Komunës së Suharekës z. Talat Xhaferi, Kryetar i tanishëm i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë.

Deri me tani z.Muharremaj ka vizituar mbi 70% të shkollave të Komunës së Suharekës, ku është njoftuar për së afërmi me gjendjen e tyre, dhe ka aprovuar që në bazë të kontrates kolektive Mësimëdhënësve t’u paguhet udhëtimi dhe pagat përcjellëse me rastin e pensionimit, duke i inkurajuar për angazhim maksimal dhe cilësi në arsim.

Kryetari Muharremaj ka arritur dhe nënshkruar deri me tani disa marrëveshje:

Marrëveshje të Mirëkutupimit dhe Bashkëfinancimit me Caritas Kosova për Projektin e “Funksionalizimi i infrastruktures për vitalizimin e projektit shtetërit shtëpiak në Suharekë – Home

Care 2018”, ku në kuadër të kësaj marrëveshje janë punësuar 15 Mjekë të Mjekësisë familjare, 31 Inferimier, 1 Farmacist dhe 3 shofer.

Momerandumi i Mirëkuptimit për Financimin e Projekteve Infrastrukturore në Komunën e Suharekës me Ministrinë e Infrastrukturës në vlerë prej 2,500,000.00 Euro.

Rezultatet në Drejtoritë përkatëse në Komunën e Suharekës:

– **Drejtoria për Administratë**, në këtë drejtori gjatë periudhës Janar-Mars, janë paraqitur gjithsej 14770 kërkesa të ndryshme, përfshirë të gjitha dikasteret e Komunës. Poashtu Drejtoria për Administratë në bashkëpunim me Qendra Komunale për Zhvillim kanë arritur këto marrëveshje dhe projekte:

Muaji Mars, Java e parë, 2018 – HELP Gjerman:

- **Projekti ‘Mbështetje stabilitetit socio-ekonomik në rajonin e Ballkanit Perëndimor 2017-2018’, organizata HELP, aplikimi për grante përfundoj me datë 09.03.2018.**
- **148 aplikacione janë dorëzuar në organizatën HELP, prej tyre 74 ishin në listë të shkurtër, 23 në listë rezerv.**
- **Në javën e fundit të muajit Mars, filloi edhe faza e dytë e përzgjedhjes, kësaj radhe në terren përfaqësuesit tanë me përfaqësuesit e organizatës HELP.**

Prill, 2018 – HELP Gjerman:

-Projekti ‘Mbështetje stabilitetit socio-ekonomik në rajonin e Ballkanit Perëndimor 2017-2018’, organizata HELP, Ka vazhduar me vizita në terren edhe në muajin Prill ku 40 biznese do të përkrahen me fondin **74.000.00 € (bashkëfinancim).**

Muaji Mars, 2018 - Asistim në projektin DEMOS Faza II:

Ka vazhduar komunikimi me përfaqësuesit e projektit DEMOS. Gjatë kësaj periudhe janë nënshkruar marrëveshjet për bashkëpunim tre – palëshe, dhe është marrë informata nga projekti që komuna janë është pranuar si e përzgjedhur për grant dhe për asistencë teknike për vitin 2018.

Prill, 2018 - Asistim në projektin DEMOS Faza II:

Nga përfaqësuesit e projektit DEMOS, Komuna u informua se është fituese e grantit me vlerë **83.000.00 €**. Është diskutuar mundësia e zhvillimit të një projekti ideor për shfrytëzimin e këtij

granti në përputhje me kriteret e projektit DEMOS “Shtigjet e Ecjes” është pranuar si një ide dhe është filluar me hartimin e projektit kryesor.

Muaji Mars, 2018

Takim me AZHR-në rreth Skema e Granteve – aplikim Prizren:

Përfaqësues të AZHR jug u takuan me kryetarin e komunës dhe stafin ku prezantuan mundësinë e bashkëpunimit me AZHR-në për implemtimin e projekteve zhvillimore komunale, spjeguan skemën e Granteve që do ta aplikojnë me Komunën e Prizrenit. Ne jemi duke shqyrtuar mundësi të gjejmë fonde dhe së bashku me AZHR-në të fillojmë me sistemin e njejtë të zbatimit të projektit të zhvillojmë projekte komunale.

Muaji Mars, 2018

Hartimi Fletushkës njoftuese mbi aktivitetet vjetore komunale dhe të Kryetarit të komunës për vitin 2018, në mbrojtje, pastrim dhe ruajtje të ambientit:

Ndër aktivitetet dhe projektet që do të zbatohen në këtë vit janë:

Fushata e pastrimit në tërë territorin e komunës;
Largimi i të gjitha deponive ilegale – tërë territori i komunës;
Pastrimi i lumunjëve - tërë territori i komunës;
Projekti: Krijimi i parqeve të gjelbërta – në tërë territorit të komunës;
Projekti: Mbrojtja dhe Ruajtja e Ambientit Hapësinor në Rajonin e Suharekës;
Plane për pastrim dhe menaxhim të qëndrueshëm të mbeturinave në secilin lokalitet dhe objekt banimi kolektiv.

Java e parë, Prill, 2018 - Njoftim për financimin e projektit “Tregu Ditor”: “Programi për Zhvillim Rajonal 2018”, fond i Ministrisë së Zhvillimit Rajonal për projekte zhvillimore në 5 rajonet ekonomike të Kosovës-Komunat e Kosovës (vlera e financimit nga 50,000.00 deri 200,000.00). Pasi projekti u dorëzua me 09.02.2018, në javën e parë të muajit Prill komuna mori informatën për suksesin e aplikacionit të projektit të tregut dhe Kryetari i Komunës nënshkroi Marrëveshjen e Bashkëfinancimit të projektit të Tregut Ditor së bashku me Ministrin e Zhvillimit Rajonal – vlera e financimit të projektit nga ana e Ministrisë **90,000.00 Euro**.

– **Drejtoria e Shëndetësisë**, Cilësia e shërbimeve shëndetësore në QKMF dhe në AMF-të në vazhdimësi me

kërkesë për përmirësim e kushteve dhe ofrimin e shërbimeve sa më të mira shëndetësore janë marrë këto vendime:

Janë hapur 2 QMF (Qendra e Mjesisë Familjare) në tre mujin e këtij viti, në Reqan dhe Bllacë, poashtu jemi në procedurë për edhe për fshatin Sallagrazhdë.

Janë aktivizuar QMF-të në 2 ndërrime: QMF në Mushtisht, QMF- në Sudenqan, QMF- në Duhël, QMF në Bukosh.

Është rregulluar orari i punës në: QKMF nga ora 8.00 deri 22.00, në Urgjencë para dite nga 8:00-16:00, pas dite 13:00-20:00, Kujdestaria: 20:00-8:00

Përmirësimi i furnizimit me barëra esenciale..

Përgatitja e procedurave për luftimin e etheve hemorragjike:

Për fazën e parë

Ligjëratat nga mjekët dhe teknikët e QKMF-së nëpër shkollat dhe komunitet për Ethet Hemorragjike. Për fazën e dytë

Ekzekutimi në teren – Dezinfektimi selektiv dhe kampanja informuese kundër Epidemisë së Etheve hemorragjike

– Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit-

Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim në tremujorshin e parë të vitit 2018 ka qenë vazhdimisht e angazhuar në punët dhe obligime të ndryshme të cilat i përkasin. Një rëndësi e madhe i është kushtuar shqyrtimit dhe mbylljes së lëndëve të trashëguara nga viti paraprak të cilat kanë qenë me një numër të madh. Në vëllimin e punëve është vërejtur një rritje sa i përket krahasimeve me vitet tjera me të njejtën periudhë.

Duke u bazuar në atë se ende nuk ka filluar shpenzimi i mjeteve për projekte kapitale të menaxhuara nga drejtoria, në kryesisht jemi marrë me fazat fillestare, ku vlen të ceket hartimin e detyrës projektuese të zonës së Qytetit- Rruga “Brigada 123”.

Detyra është hartuar nga sektori i urbanizmit me kërkesë të kryetarit dhe në kordinim me Drejtorinë për Shërbime Publike, Mjedis dhe Emergjencë.

Gjatë periudhës 05.01.2018e deri me 30.03.2018 janë pranuar 85 lëndë, ndërsa janë përcjellë 148 shkresa rreth lëndëve të pranuar si dhe të karakterit të ndryshëm. Gjatë këtij tremujori janë mbajtur takime të shumta në nivel komunal për PZHK (Plani i Zhvillimit Komunal), organizata, institucione lokale dhe qendrore.

Kjo drejtori kryesisht në këtë tremujorsh është marrë me:

- Përcjellëse të proceseve të hartimit të profilit për PZHK dhe projekteve tjera që ka nën menaxhim.
- Revidimin e projektit të shtëpisë së kulturës në perputhje me dispozitat ligjore;
- Përgjigje në shkresa të palëve varësisht nga karakteri i tyre;
- Përcjellja e ankesave të palëve për ministrinë përkatëse;
- Leje ndërtimi dhe leje rrërimi;
- Leje të ndryshme për objekte si: ndryshim destinimi, renovime, aneksime, mbindërtime, shfrytëzim të hapësirave për ekspozim malli, vendosja dhe vazhdim afati për objekte të përkohshme, etj.
- Raporte të ndryshme për kryetarin dhe drejtorinë.
- Njoftime publike, Njoftime rreth kushteve ndërtimore, Kushte Ndërtimi, Vërtetime Urbanistike, Pëlqime Urbanistike dhe Pëlqime në parim, etj.
- Konkluzione të ndryshme.
- Dalje në teren për lëndë të caktuara dhe verifikimi i kërkesave të ndryshme.
- Vlerësime të ndryshme urbane dhe ndërtimore me kërkesë të palëve apo dhe nevoja të komunës.

-Drejtoria e Arsimit -

OBJEKTIVAT E DKA-së TE PLANIFIKUARA

Drejtoria e Arsimit ka hartuar plan- programin e punës për vitin shkollor 2017/2018 në kuadër të cilit ka planifikuar realizimin e këtyre objektivave kombëtare dhe strategjike të MASHT si dhe objektivave komunale :

Ngritjen e cilësisë së mësimdhënjes dhe mësimnxënjes në shkollat tona.

- Ngritjen e suksesit të nxënësve dhe rritjen nivelit të vijueshmërisë së nxënësve në procesin edukativo-arsimor
- Realizimin e plan-programeve mësimore
- Ngritjen profesionale të mësimdhënësve
- Ndërtimin, renovimin dhe rregullimin e objekteve shkollore.
- Rregullimin, pastrimin dhe mirëmbajtjen e ambientit të brendshme dhe të jashtëm të shkollave
- Monitorimin e punës në të gjitha institucionet shkollore .
- Bashkëpunimin me donatorë të jashtëm e të brendshëm për investime në shkoll

- Është formuar grupi punues për hartimin e Planit zhvillimor të Arsimit në nivel komune me vendim të Kryetarit

- Është arritur Marreveshje me LUX-DEV për edukimin në karriere të mesimdhënsve dhe të nxënësve nga kalsa e VI- XII.

Në vitin shkollor 2017/2018 në të gjitha nivelet e shkollimit janë regjistruar 12870 nxënës
Në nivelin I-V janë regjistruar 4516 nxënës të shpërndarë në 243 paralele.

Në nivelin VI-IX janë regjistruar 3775 nxënës të shpërndarë në 192 paralele.

Në nivelin X-XIII janë regjistruar 3887 nxënës të shpërndarë në 118 paralele .

Në çerdhen e fëmijëve janë të regjistruar 61 fëmijë me 3 paralele dhe në paralelet parafillore janë të regjistruar 778 fëmijë të shpërndarë në 34 paralele .

Kuadri : Në arsimin parafillor, fillor , të mesëm të ultë dhe të mesëm të lartë janë të angazhuar 990 punëtorë .

Në kuadër të punëve dhe aktiviteteve të planifikuara në këtë tremujor DKA ka realizuar :

Suksesi dhe vijimi i nxënësve :

-Në gjysëmvetorin e parë nxënësit kanë arritur këtë sukses:

Në nivelin I- IX

Sukses pozitiv kanë arritur 6998 nxënës ose 87.31%,

-Negativ 1017 nxënës ose 12.69 % ,

- Pa notuar 291 nxënës

Në nivelin X-XII :

-Sukses pozitiv kanë arritur 1630 nxënës ose 54.4 % ,

-Negativ 1369 nxënës ose 45.6% ,

- Pa notuar 84 nxënës

Në bazë të raporteve të shkollave, rezulton që në fund të gjysëmvetorit të parë vitit mësimor 2017/2018 vijimi i nxënësve është në nivel më të kënaqshëm krahasuar me vitin e kaluar por gjithmonë duhet të synojmë në zvogëlimin e numrit të mungesave.

DKA me qëllim të avancimit të punës në institucionet shkollore deri në këtë periudhë ka organizuar vizita në SHFMU dhe SHFML, qëllimi i vizitës ishte :

1. Kontrollimi dhe marrja e informatave për dokumentacionin pedagogjik
2. Numrin e paraleleve ndarjen e orëve mësimore
3. Funksionimi i aktiveve profesionale,
4. Kuadri
5. Gjend. e objektit shkollor dhe ambienti i jashtëm
6. Menaxhimi i bugjetit

7. KDSH

8. Performanca e mesimdhënësve
9. Libri i te punësuarve
10. Libri i protokolit
11. Koordinimi i cilesise
12. Ekipi per braktisje
13. PZSHSH
14. Monitorimi
15. Planet e drejtorit
16. Organizimi i mësimit plotësues dhe shtues.
17. Orët e humbura
18. Mjetet mësimore
19. Aktivitetet jashtëmesimore

Për të gjitha shkollat fillore e të mesme të ulëta dhe të mesme të larta, janë hartuar procesverbalet e inqizimit të gjendjes së bashku me rekomandimet për të eliminuar lëshimet e konstatuara.

Të gjitha procesverbalet e shkollave janë të protokoluara dhe të nënshkruara nga DKA-ja dhe drejtorët e shkollave, janë duke punuar në eliminimin e të gjeturave gjatë vizitave në këto institucione. Aplikimi dhe realizimi i plan-programeve të punës :

Në bazë të vizitave (kontrollimeve) që ka bërë DKA- ja dhe raporteve të shkollave në kuadër të tri niveleve të edukimit rezulton se plan –programet e punës dhe ditet e mësimit –punës të planifikuara me kalendar shkollor janë realizuar për këtë periudhë kohore me perjashtim te ditëve të grevës të

organizuar nga SBASHK-u dhe ditëve kur është ndërpre mësimi nga MASHT për shkak të motit të ligë. Kompenzimi i këtyre ditëve planifikohet nga MASHT.

DKA ka përgaditur rekomandimet për shkolla për realizimin e projektet për zhvillimin e aktiviteteve dhe garave për ngritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies.

Fokusi ka qenë që të gjitha aktivitetet të barten në shkolla në mënyrë që të përfshihen dhe motivohen i të gjithë nxënësit pa përjashtim .Gjithashtu në këtë periudhë janë organizuar garat :

- Olimpiada e matematikës dhe

- Dita e Ujit

Ku janë përfshirë të gjitha shkollat e Komunës sonë me që rast janë ndarë edhe shpërblime për nxënësit fitues.

DKA në bashkëpunim me komunën me rastin e Festës së “7 Marsit”, ka organizuar aktivitete në kuadër të shkollave gjithashtu edhe aktivitetin qendror me një program modest, në të cilin janë ndanë mirënjohje për mësuesin më të mirë të përcaktuara në bazë të kriterëve dhe vlerësimit të performancës nga drejtorët .

Me këtë rast për herë të parë DKA ka nda mirënjohje për të gjithë mësimdhënësit e pensionuar në vitin 2017.

Në kuadër të planifikimeve të MASHT në Komunën e Suharekës u realizua testimi “ PISA 2018 ” këtij testimit iu nënshtruan 28 nxënës nga katër shkollat fillore (Kongresi i Manastirit” -Studençan, “ Dëshmorët e Greikocit”- Greikoc, “ Dituria” – Samadrexhë, “ 17 Shkurti”-Shirokë) dhe 123 nxënës nga tri shkollat e mesme të komunës sonë.

DKA në Suharekë ka bërë përgatitjet e duhura për realizimin e këtij procesi duke u siguruar shkollave pjesëmarrëse të gjitha kushtet e nevojshme.

Testi u realizua në objektet e shkollave si në vijim:

Nxënësit e SHFMU “ Dituria” – Samadrexhë dhe të SHFMU “Kongresi i Manastirit”- Studençan testin mbajtën në SHFMU “17 Shkurti”-Shirokë;

Nxënësit e SHFMU “ Dëshmorët e Greikocit”-Greikoc testin mbajtën në shkollën e tyre;

Nxënësit e tri shkollave të mesme të larta realizuan testin në shkollat e tyre.

Në këtë vit shkollor DKA ka shpall konkurs për ndarjen e bursave në të cilin kanë qenë 397 aplikues prej tyre 164 janë aprovuar (109 student dhe 55 nxënës ndërsa janë refuzuar 233 kërkesa.

Gjendja e sigurisë së përgjithshme në Kosovë përgjatë viteve të fundit është konsideruar në përgjithësi si stabile. Duke qenë se nxënësit një pjesë shumë të madhe të kohës e kalojnë në

ambientet shkollore, është shumë e rëndësishme që jo vetëm për mirëqenien e tyre po edhe për vetë procesin edukativo-arsimor, të ketë siguri të lartë në shkollë. Natyrisht, se janë një sërë faktorësh të cilët ndikojnë në krijimin e bindjeve dhe perceptimeve për sigurinë në shkollë.

Si Drejtori Komunale e Arsimit kemi kërkuar, që organet e sigurisë të përcjellin situatën e sigurisë në qendrën zejtare Nr.2 dhe kemi rekomanduar Kuvendin Komunal që të gjejë forma për përmirësimin e gjendjes së sigurisë për shkollat në fjalë por jo vetëm për këto shkolla, për sigurinë në shkolla në tërësi. DKA në mbështetje të Ligjit për Arsimin Para Univerzitar dhe rregulloreve në fuqi do të hartoj projekte për sigurinë e nxënësve në shkolla dhe ambiente për rreth.

DKA ka menaxhuar edhe gjendjen e objekteve shkollore : Pregaditja e paramasave për adaptime ,meremetime në shkolla, furnizimi me material zyrtar për administratë dhe shkolla, planifikimi dhe mirmbajtja e ngrohjes qendrore në shkolla, planifikimi i punimeve tjera në kordinim me drejtorët e shkollave sipas buxhetit që kanë shkollat.

Është duke u realizuar projekti për rregullimin e tualeteve në SHFMU “Kongresi I Manastirit” – Studenqan me vlerë: 6500€, është bërë po ashtu furnizimi me lëndë djegëse (shitesë) ”Abdyl Ramaj”- “Edit Durham” në Mushtisht, Besim Ndrecaj ”Maqitevë “Shkëndija”, Ramë Bllaca ‘Bllacë” Gjimnazi “Jeta e Re” ‘Shaban Mazreku”-Sopijë” Sadri Duhla” Duhël

-Drejtorja për Ekonomi dhe Financa- Sektori i Tatimit në Pronë : - Në muajin Janar ne kete sektor jane pergaditur te gjitha faturat e TPR-së, për të gjithë obliguesit tatimor ku në total faturat për vitin 2018 kanë qenë 14379 fatura.

Ne muajin Shkurt dhe Mars ky sektor ka bere evidentimin e te gjithe obliguesve tatimor me borgje me mbi 1000.00 € , ka shtypur faturat e ketyre borgjlive ku se bashku me fletedergesat dhe vërejtjet qe jane shperndare e ku ne total nr.i ketyre obliguesve tatimor ka qene 565 obligues dhe vlere e ketyre faturave me borgje arrin ne 1.080.741.75 € . Perveq kushtezimit qe praktikojme edhe keto verejtje ka luajtur nje rol shume te madhe ne inkasimin e te hyrave ne TPR ku per tre muaj nga ky sektor jane realizuar 145,559.15 € (Janar-54462.32 Shkurt 34893.52 dhe Mars 56203.31) qe krahasuar me vitin e kaluar per muajt e njejte (Janar-Shkurt-Mars 2017=119,842.01) jemi + 25,717.14 € mirepo te hyrat ne pergjithesi jane; Janar- 113,835.00 € ,Shkurt- 93,461.69 €, Mars- 12,7203.91 € per tre muaj totali i te hyrave ne pergjithesi eshte 334,501.42 €(pa perfshire denimet e gjykatave) qe krahasuar me vitin 2017 per te njejten periudh jemi -66,094.66 €. Sa i perket regjistrimit te objekteve nga ekipet e terenit edhe pse kane filluar koheve te fundit per regjistrim deri me tani jane regjistruar 135 objekte ku prej tyre 86 objekte te reja dhe 49 verifikime apo korigjime qe krahasuar me vitin 2017 ku gjate tere vitit jane regjistruar 368 objekte ne total ku prej tyre 195 te reja 173 verifikime kete vite jemi shume me mire me regjistrim te objekteve sipas planit te parapare ku parshihen te

regjistrohen diku rreth 1200 objekte te reja . Gjate muajit mars dhe prill jemi duke pranuar ankesat e tatimpaguesve ku deri me tani jane bere 105 ankesa ku keto ankesa do te shqyrtohen ne muajin Maj nga komisioni i formuar siq e parashih ligji i Tatimit ne Prone.Gjithashtu ne kete sektor jane bere gjithsej 365 kerkesa per qertifikata te perfitim te skemes sociale.

Sektori i Financave ; Ne kete sektor ne muajin Janar dhe Shkurt jane bere ngarkesat e tri kategorive te te hyrave Takses,Rentes dhe Qirase ku Taksa ne Akticitet ka pasur gjithsej 2178 obligues,Qiraja 25 obligues dhe Renta 117 obligues qe ne total te tri kategorite kane 2320 obligues tatimor .Te gjithë ketyre obliguesve i eshte shtypur fatura dhe derguar me poste ne adresat e pronareve.Ne muajin mars kemi filluar me pergaditjen e listave te obliguesve te medhenj ku dhe kemi bere gati te gjitha verejtjet per te tri kategorite dhe gjate muajit Prilldhe Maj do te fillojme me verejtje per te tri kategorit per te gjithë ata obligues qe kane mbi 1000.00 euro borgje njokehesisht jemi duke marre te gjithë numrin e punëtoreve te sherbyesve civil ne institucione tona si ne Administrate,Arsim,QKMF etj dhe do te bejme verifikimin e tyre dhe te gjithë ata te cilet kane borgje do te iu behet njoftimi dhe verejtja per mospagesen e borgjit.Gjate ketij tremujori ne te tri kategorit jane bere gjithsej 151 pagesa ne vlere totale prej 61,857.87 € ku Taksa ne Aktivite ka 31897.80 €, Qiraja 13939.00 € dhe Renta 16021.07 €.

-Drejtoria për Inspeksion-

Drejtorija e Inspeksionit , gjatë periudhës tre mujore Janar - mars 2018, ka kryer këto punë nga lëmia e kompetecave që ka me Ligje, udhëzim administrative dhe vendime komunale.

Në përgjithsi puna e Inspeksionit eshte perqendruar ne keto lemi : në parandalimin e ndertimeve pa leje, parandalimin e keqperdorusve të ujit të pijes, parandalimi i hudhjeve të mbeturinave në vendet jo te destinuara për këtë qëllim , eliminimi dhe luftimi i bizneseve ilegale , mbrojtjes së konsumatorit, kontrollimin dhe inspektimin e Restoranteve dhe bizneseve qe tregtojnë artikuj ushqimor , mbrojtjen e tokave bujqesore dhe kontrollimi I imputeve bujqesore dhe produkteve kimike per brojtjen e bimeve, mbikqyrja e vijave per transportin local të udhëtarve si dhe mbrojtjen e shendetit të popullsisë .

Për këtë periudh janë kryer punë si më poshtë:

Numri i përgjthshëm i kontrollimitdherikontrolimittëbizneseve	415
Proqesverbele	332
Aktvendime	38
Konzervimi i objekteve me shiritrrthues	2

Pranimeteknike – Aktvendime	27
Procedurë për kundërvajtje	10
Rrënimi i objekteve pa leje (Obj.perkoheshme montazh)	2
Pelqime te komunikacionit - sanitar	4
Aktpercjellje	3
Qertifikata të origjines së produkteve	64
Qertifikata të therrrjes	64
Marrja e mostrave per analiz	0
Groposje dhe asgjesim te lopeve me LSD	0
Groposje dhe agjesim te lopeve me TBC	0

-Drejtoria e Shërbimeve Publike, Mjedisë dhe Emergjencë-

Sektori i Shërbimeve Publike- Gjatë 3 muajve – raportit vjetor të vitit 2018, në Sektorin e Shërbimeve Publike dhe Mjedis, janë kryer punë të ndryshme që kanë të bëjë me natyrën e punës së kësaj drejtorie. Disa nga punët më të rëndësishme, me të cilat ishin të angazhuar të punësuarit e kësaj Drejtorie ishin:

- Kryerja (përgatitja) e faturave të ujit , rrymës, telefonit , mbeturinave, projekteve të ndryshme , si dhe shumë faturave të ndryshme të komunës.
- Realizimi i vizitave në teren për çështje të ndryshme (strehim, kanalizim, ujësjellës dhe infrastrukturë),
- Lëshimi i dokumenteve për persona fizikë dhe institucione,
- Angazhimi në komisione të ndryshme në Komunë,
- Në bashkëpunim të ndërsjellë me disa drejtori të (Drejtorin e Urbanizmit, Zyrën e Prokurimit dhe Drejtorin e Arsimit (DKA) e tjera), pastaj me “Hidro-regjionin Jugor” njësia Suharekë, “ Eko-regjionin “ njësia Suharekë, KEDS-in, PTK-në etj.
- Gjithashtu DSHPME në Bashkëpunim me organizatën Qeveritare (Japoneze) JICA është në koordinim rreth implementimit të planit rregullues për menaxhimin e mbeturinave (i cili është miratuar 01.03.2016 nga Asambleja Komunale),

-Eko-regjioni dhe Komuna e Suharekës ka kontratë kornizë për mirëmbajtjen dhe pastrimin e qytetit.

- Drejtoria e shërbimeve publike dhe Emergjente gjatë 3 mujorit të parë të këtij viti 2018 ka arritur të siguroj të hyra Komunës së Suharekës nga kryerja e shërbimeve një vlerë 80.00 Euro;

- Po ashtu DSHPME ka kontratë për mirëmbajtjen e ndriçimit publik në Komunë(Suhareka, Mushtisht, Studençani, Samadrexha, Shirokë).

-Kemi kontratë Mirëmbajtja dimërore e rrugëve lokale, ku gjatë kësaj periudhe kemi bërë 502 orë punë efektive, janë harxhuar 318 tonë kryp, janë pastruar gjithsej 152 km Rrugë.

Totali i kërkesave të ndryshme në 3 (tre) mujorin e parë të vitit 2018 në DSHPME është gjithësej:

Drejtoria e Shërbimeve Publike Mjedis dhe Emergjente	Të Pa shqyrtuar	Në proces	Miratuar	Refuzuar	Hedhur poshtë	Pezulluar	Total
178	14	60	55	47	1	1	178

Mjedisi: Në këtë sektor kemi pranuar 5 Kërkesa për Leje mjedisore, ku 4 prej tyre janë miratuar ndërsa njëra është në proces. Përveç kësaj ky sektor gjatë muajve Janar, Shkurt dhe Mars ka pasur bashkëpunim të mirë me të gjitha drejtorit e komunës sonë. Gjithashtu kemi punuar në hartimin e projekteve (4 projekte) ku në bazë të këtyre projekteve kemi konkurruar në ministrit përkatëse.

1. Krijimi i parqeve të gjelbërta – mbjellja e fidaneve për gjatë rrugës Suharekë – Prizren
2. Mbrojtja e ruajtja e ambientit hapsinor në rajonin e Suharekës- bjeshkët e sharit
3. Pastrimi i profileve kritike – emergjente të lumenjeve për mirëmbajtje të kapacitetit bartës të ujërrjedhave .
4. Rregullimi i shtratit të lumit topllua – Suharekë .

Infrastruktura:

Gjatë kësaj periudhe janë kryer punët dhe shërbimet si në vijim:

- Menaxhim të projekteve të bartura nga viti 2017 gjithsejtë projekte prej të cilave janë duke u zhvilluar punimet.
- Mbikqyrje të projekteve të bartura nga viti 2017
- Organizimi i takimeve për diskutimin dhe vlerësimin e gjendjes e projekteve të bartuara, takime të përbashkëta me O. E. – punëkryesit,
- Sistemimi i lëndëve të realizuara gjatë vitit paraprak dhe nxjerrja e raporteve,
- Komisione pranë zyres së prokurimit(Hapjes së Ofertave dhe Vlersimit të Ofertave),
- Komisione për vlerësimin e kërkesave të palëve,
- Komisione për vizita në teren dhe përcaktimin e gjendjes ekzistuese (dëmeve, projekteve, etj.),
- Komisione dhe asistencë profesionale pranë drejtorive tjera,

- Hartim të paramasave sipas kërkesave të eprorit,
- Përgatitja e dokumenteve nga kërkesat e palëve-raporte etj.,
- Analiza e buxhetit për vitin 2017 – përgatitja dhe bartja e mjeteve për vitin fiskal 2018,
- Analiza e projekteve dhe gjendja e pagesave,
- Përgatitja e dokumentacionit për projekte të ndryshme investive duke filluar nga përgatitja e projekteve ideore e gjerë në finalizimin e plotë të projektit (projekti zbatues), paramasave dhe parallogarit.

-Takime me stafin e drejtoris dhe O.E. të kontraktuar për PZHK,

-Trajnim për programin QGIS Essen, etj.

- Inicimi i procedurave të tenderimit për investimet kapitale 2018;

1. Fondi emergjent - furnizimi me zhavorr, për rrugët e dëmtuara

2. ndërtimi i rrugëve lokale – 9 lot

3. ndërtimi i rrugëve lokale - 12 lot

Të gjitha këto projekte janë në procedur të prokurimit.

Sektori i Shërbimit të Zjarrfikësve dhe Shpëtimit:

Realizimi i numrit të përgjithshëm të intervenimeve për periudhën Janar-Mars 2018

Sektori i Sigurisë dhe Emergjencës :

Gjatë kësaj periudhe tre mujore kam kryer punë dhe aktivitete të përditshme, duke u bazuar në planin e punës, si dhe në kërkesat e paraqitura nga qytetarët e komunës sonë.

JANAR

1. Mbikqyerja e punimeve rreth pastrimit të borës në rrugët lokale të KK-Suharekë.
2. Duke u bazuar në shënimet e DSHP, Sigurisë dhe Emergjencës, me kërkesë të palëve lëshohen vërtetime për personat që janë vrarë, zhdukur dhe plagosur brenda periudhës së luftës 27.02.1998 deri më 20.06.1999.

Për civilët e vrarë në luftë-----	03
- Për civilët e zhdukur në luftë-----	00
- Për civilët e plagosur në luftë-----	05
- Personat që e kanë të rregulluar shërbimin ushtarak në ish armatën jugosllave si dhe personat që janë shpall të paftë, apo janë liruar.-----	00

SHKURT

3. Mbikqyerja e punimeve rreth pastrimit të borës në rrugët lokale të KK-Suharekë.

4. Duke u bazuar në shënimet e DSHP, Sigurisë dhe Emergjencës, me kërkesë të palëve lëshohen vërtetime për personat që janë vrarë, zhdukur dhe plagosur brenda periudhës së luftës 27.02.1998 deri më 20.06.1999.

- Për civilët e vrarë në luftë-----04
- Për civilët e zhdukur në luftë-----00
- Për civilët e plagosur në luftë-----00
- Personat që e kanë të rregulluar shërbimin ushtarak në ish armatën jugosllave si dhe personat që janë shpall të paftë, apo janë liruar.-----00

MARS

5. Hartimi i planit vjetor për vitin 2018, plotësimi, ripërtrirja e aneks planeve: Vlerësimi të rrezikut përcjellja permanente dhe bartja e ndryshimeve në to.

6. Mbikqyerja e punimeve rreth furnizimit me zhavor dhe shtrimi i rrugëve lokale të KK-Suharekë.

7. Mbikqyerja e punimeve rreth pastrimit të borës në rrugët lokale të K.K Suharekë

8. Vërtetime për personat që janë vrarë, zhdukur dhe plagosur brenda periudhës së luftës 27.02.1998 deri më 20.06.1999.

- Për civilët e vrarë në luftë-----10
- Për civilët e zhdukur në luftë-----18
- Për civilët e plagosur në luftë-----01

-Personat që e kanë të rregulluar shërbimin ushtarak në ish armatën jugosllave si dhe personat që janë shpall të paftë, apo janë liruar.-----02

Spektori: Inspektori i Preventives së Zjarrit:

Më poshtë do të evidentoj punet të cilat janë kryer në muajin Janar duke u bazuar në Planin vjetor të punës.

Inspektime të rregullta.....18

Në sektorin Publik.....3

Në sektorin privat.....17

Inspektime kontrolluese.....18

Masa të shqiptuara.....78

Aktvendime.....3

Dalje në vendngjarje me rastin e zjarreve.....1

- Drejtoria për Shërbime Pronësore-Juridike dhe Kadastër-

Drejtoria e Shërbimeve Pronësore-Juridike dhe Kadastër , gjatë këtij 3 (tre) muaji ka vazhduar të ofroj shërbime sa më efektive për qytetarët duke u ofruar informacione dhe të dhëna për pronat e sektorit privat dhe atij komunal.

Gjatë kësaj periudhe në zyrat pritëse të dy sektorëve, Sherbimit Pronsor Juridik dhe Kadastrë janë pranuar gjithsej 338 lëndë për regjistrim, bashkim, ndarje të parcelave , si dhe 2000 lëndë të protokollit në(sektorin e kadastrit) , dhe 70 lëndë në (Sektorin e Prones), poashtu gjatë kësaj periudhe Shërbimi Pronsor Juridik dhe Kadastrë ka pasur një bashkëpunim të ngushtë edhe me Drejtorin e Urbanizmit, Drejtorin e Sherbimeve Publike, Drejtorin e Bujqësis, dhe në bazë të kërkesave të tyre kemi dalur në teren dhe kemi identifikuar pronat komunale (rrugët) e uzurpuara të cilat janë liruar për realizimin e projekteve të tyre . Gjatë kësaj periudhe si objektiv kemi pasur edhe inkasimin e të hyrave nga qiraja dhe renta e pronës komunale dhe deri diku kemi arritur të realizojmë këtë objektiv përmes njoftimeve të qiramarrësve me shkrim .

Gjatë kësaj periudhe kam pasur takime të ndryshme me përfaqësuesit e INSI-it për (Planin Zhvillimor të Komunës), me përfaqësuesit e KOSST-IT për (ndryshimin e trases në Zonen Industriale në Shirok të tensionit të lart 110 KV Therandë – Rahovec, takim me përfaqësuesit e USAID-it ku kemi diskutuar lidhur me të drejtat pronore.

Kërkesat për periudhën Janar-Mars 2018, në sektorin e Kadastrit

Nr. rendor	Lloji i lëndëve të kryera	Numri i lëndëve të kryera
1.	Lëndë për regjistrim ndarje dhe bashkim të parcelave	114
2.	Lëndë të regjistruara mbi të drejtën e pronës (RDPP)	338
3.	Qertifikata që posedojn pasuri	1759
4.	Qertifikata që nuk posedojn pasuri	303
5.	Kopje planit	227
6.	Ekspertiza	20
7.	Lëndë të protokollit	2064
8.	Identifikimi i parcelave sipas kërkesave të pales	2526
9.	Përgatitja e kordinatave për gjepdetët e licensuar	105
10.	Ndarje , bashkim parcelave	107
11.	Dalje ne teren	30

Vërejtje : Të gjitha lëndët janë kryer mrenda afatit ligjor !

Në Shërbimin Pronësor-Juridik është vazhduar me lëndët të cilat kanë qenë të papërfunduara nga viti paraprak, dhe lëndët e këtij viti kalendarik .

Kryesisht zyrtarët e Shërbimit Pronësor-Juridik janë fokusuar në zgjidhjen e lëndëve , të cilat kanë të bëjnë me shpronsimet , ekzekutimet, raporte të ndryshme, njoftime të palëve rreth pagesës së qeras dhe rentes , lirimit e hapsirave publike , identifikimin e parcelave të lira në Zonen Industriale në Shirok, dhe Agrozonen në Samadrexh , si dhe dedikimi i veprimtarisë për këto parcela . Gjatë kësaj periudhe janë realizuar edhe dalje në teren nga sektori i pronës.

-Drejtoria për Bujqësi, Zhvillim Rural dhe Pylltari- Në këtë drejtori mbrenda kësaj periudhe janë kryer dhe marrë masa për këto aktivitete:

1. Organizimi takimit me fermer të komunës së Suharekës në bashkëpunim me stafin e Fondit Lokal për Zhvillim –LDF “Susi2” për thirrje publike për aplikim në projekte për fermer të vegjël.
2. Organizimi i takimit me zv. Ministrin e Bujqësisë- Vesel Krasniqi dhe përfaqësuesin e Usaid-it Amerikan-ku pjesëmarrë në takim kanë qenë mbi 50 fermerë ,
3. Organizimin e takimit me shef. E Pylltarisë-Ahmet Zejnullahu nga Agjencioni i Pyjeve-MBPZHR, ku tem diskutimi ka qenë Mbrojtja e pyjeve nga prerjet ilegale.
4. Pranimi i tre puntorëve-praktikanta në afat tre-mujor nga projekti LDF-së, për të ndihmuar stafin në plotësimin e aplikacioneve të fermerëve për subvencione.
5. Takimi me Drejtorin e Bankës TEB, ku është diskutuar për kreditimin e fermerëve.
6. Pranimi i 5 ekspertave të bujqësisë-për këshilla të fermerëve në teren,
7. Organizimi i takimeve me zyrtarët Japonez të JICA-për zhvillimin e Turizmit Rural në komunëne Suharekës.
8. Takimi me katër Drejtori të Komunave: Suharekë, Prizren dhe Shtërpc, në bashkëpunim për mbrojtjen e pyjeve nga dëmtuesit ilegal,
9. Nga Stafi i Drejtorisë është punuar në përgaditjen e të dhënave- Raporti dhe strategjia sektoriale për sektorin e bujqësisë-Profil i sektorit dhe vlerësimi i gjendjes në bujqësi në projektin ”Plani zhvillimor komunal”-Insi.
10. Takimi me USAID-in Amerikan- për projektin- furnizim me fidane të dredhëzes.
11. Vizita studimore 3 ditore-shkollës bujqësore Amerikane në GREQI, organizuar nga LDF.
12. Përgaditja e dy projekteve të kanaleve për Ujitje në fshatin Studenqan dhe Vraniq dhe dorëzimi në MBZHR në Prishtinë.

Përgaditja e projekteve për tenderim:

Ngritja e serave, rregullimi shtallave për bagëti, ndërtimi infrastructures rrugore-fushore

14. Nga Zyra për Këshillime- për fermer është organizuar Trajnimi me temën: Përdorimi i Plehrave Mineral dhe roli i tyre-pjesëmarrs 16 fermer.

15. organizimi i vizitës studimore te kompania e qumështit “NATYRA” në fshatin Sallagrazhdë, në bashkëpunim me MBZHR dhe kompania implementuese ESG.

16. organizimi i trajnimit në bashkëpunim me Ambulancën veterinare me ekspert të huaj me temën: Të ushqyerit e kafshëve dhe mirëmbajtja e thundrave, për fermerët e komunës së Suharekës.

17. në teren nga zyrtarët për bujqësi janë vizituar dhe këshilluar fermerët në Sera, ferma blegtorale, dhe bletare.

18. Për subvencione-pagesa direkte nga MBPZHR, për fermerë janë plotësuar dhe digjitalizuar në sitemin e efr dhe elpis gjithsejtë 1220 aplikacione.

19. Për shkak të volumit të punëve në plotësimin e Aplikacioneve për Subvencionimin e bujqëve-pagesa direkte, stafi profesional i Drejtorisë ka punuar edhe ditëve të shtune.

20. **Pylltari-** janë pranuar 164 kërkesa për damëkosjen në pyje private.

21. janë dërguar në Gjykat- 40 fletëparaqitje kundërvajtëse për dëmtuesit ilegal, Penale janë dy fletëparaqitje.
22. janë konfiskuar 25.52 m³ dru nga dëmtuesit,
23. Në depo-Shirokë kemi 101.26 m³ dru të konfiskuar.
24. në bazë planit vjetor- në Biraq janë damëkosur 140 copë pisha, sipas eksperteve të pylltarisë nga APK-së, është parapar të bëhet rrallimi i pishave përshkak të dendësis së tyre.
25. APK ka pranuar 9 puntorë me kontratë 7 mujore të cilët kujdesën për mirëmbajtjen sipërfaqeve prej 50ha që janë mbjellur me pish vitin e kaluar në fshatin Greikoc.
26. Agjencioni i pyjeve të Kosovës në bashkëpunim me Shoqatën SNVP për menagjimin e përbashkët të pyjeve ju ka nda 74 familjeve në fshatin Samadraxhë, në sipërfaqe prej 1-2 ha tokë pyjore të cilit kanë për detyrë ruajtjen dhe kultivimin e masës drusore në pyje.
27. Firma Angleze “HELLO TRASTT” me seli në Gjakovë në bashkëpunim me FSK-ën janë duke bërë pastrimin e terenit pyjor nga minat në Caralevë.
28. është duke vazhduar regjistrimi dëmeve pyjore në bashkëpunim me APK-në në terenet “Koka e Ahut 1,2” Maqitevë dhe Delloc.
- 28.Për qdo muaj bëhet dërgimii raporteve mujore në DKRP në Prizren.
- 29.Për çdo ditë bëhet kontrollimi i tereneve pyjore dhe i rojeve të pyllit dhe ndërmirren planet operative në orët e hershme dhe në mbremje.
- 30.Nga ekspertat e Bujqësisë në teren janë bërë gjithsejtë 75 vizita te fermerët.
31. Janë kryer edhe punë tjera sipas nevojës së DBZHRP.